



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 398 Dt 16.02.2022

Senati i Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 15.02.2022, mori:

VENDIM

I. Anulohet pjesërisht konkursi për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë, i publikuar më 01.10.2021, i përmirësuar më 04.10.2021 dhe 14.10.2021.

II. Anulimi i konkursit nga pika I, do të bëhet për këto pozita:

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

1. Një mësimdhënës për lëndët: Grup lëndësh nga informatika inxhinierike.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Qarqe kompjuterike, Komponentet elektronike, Elektronika digjitale, Simulimet me kompjuter, Automatizimi i prodhimitarisë dhe robotika.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Teknologjia e përgjithshme e materialeve, Vizatim teknik me gjeometri deskriptive, Teknikat matëse, Vizatim me kompjuter, Softuer aplikativ
4. Një asistent për Grup lëndësh nga Ekonomia.

Fakulteti i Edukimit

1. Një mësimdhënës për lëndët: Shkenca shoqërore në arsimin fillor, Shkenca shoqërore në edukimin parashkollor, Edukatë qytetare, Shkolla dhe komuniteti.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Metodologji e leximit letrar, Histori e letërsisë kombëtare, Letërsi për fëmijë, Metodologji i leximit letrar.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Metodologji e përgjithshme me praktikë, Praktika pedagogjike II me metodologji, Praktika pedagogjike me metodologji III, Teoria e mësimit, Shkathtësitë e mësimit akademik.
4. Një asistent për lëndët: Hyrje në psikologji, Puna me fëmijë të talentuar, Psikologji edukimi, Psikologji e personalitetit, Psikologji zhvillimore.
5. Një asistent për lëndët: Shkencat natyrore në arsimin fillor I, Bazat e shkencave natyrore në edukimin parashkollor II, Bazat e shkencave natyrore në arsimin parashkollor I, Shkencat natyrore në arsimin fillor II, Eksperimenti në fëmijërinë e hershme, Edukim mjedisor.
6. Një asistent për lëndët: Filozofi e edukimit, Metodologji e përgjithshme me praktikë I, Praktika pedagogjike II me metodologji, Menaxhimi i klasës, Tendencat bashkëkohore në arsim, Vlerësim në arsim, Bazat e hulumtimit në edukim, Bazat e hulumtimit në arsim.
7. Një asistent për lëndët: Praktikë Pedagogjike me Metodologji III, Zhvillim i Kurrikulave, Praktika pedagogjike, Teori e mësimit, Zhvillim i kurrikulave, Zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe portfoliot.
8. Një asistent për lëndët: Histori kombëtare, Historia e arsimit kombëtar, Edukatë qytetare.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitat nga pika II bëhet për arsye të mos respektimit të afateve të përcaktuara me Rregulloren 1667, dt. 28.09.2021.

Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rr. (St.)Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditës nga shpallja e njoftimit, në Komisionin për ankesa dhe parashtresa të Senatit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrës për informim me publikun

The image shows a circular official stamp of the University of Mitrovica (UMIB) in blue ink. The stamp contains the text "UNIVERSITETI I SA BOLETINI" at the top and "MITROVICE" at the bottom. In the center of the stamp is a logo featuring an open book. Overlaid on the right side of the stamp is a handwritten signature in blue ink. To the right of the stamp, the text "Prof. dr. Alush Musaj" is printed above a horizontal line, and "Kryesues i Senatit" is printed below the line.

Prof. dr. Alush Musaj
Kryesues i Senatit